



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 7, datë 31.01.2018

PËR
MIRATIMIN E SHOQËRISË AUDITUESE “LIRENG AUDITING” SH.P.K. PËR
AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN 2017, TË BYROSË
SHQIPTARE TË SIGURIMIT

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 5, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 42, pika 9, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, të neneve 123 dhe 124, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të Rregullores nr. 37, datë 28.05.2015 “Për përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për përzgjedhjen e shoqërisë audituese për shoqërinë e sigurimit”, me propozim të Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shoqërisë audituese “Lireng Auditing” sh.p.k. për auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2017, të Byrosë Shqiptare të Sigurimit.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI